



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 688/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “R...” sh.p.k. me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim S.K avokat nga Lipjani, kundër debitorit “K...” sh.p.k. me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.301/2021 të datës 25.11.2021 të Përmbartuesit Privat Emine Sherifi-Lubeniqi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 21.11.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “K...” sh.p.k. me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër urdhrit përmbartimor P.nr.301/2021 të datës 25.11.2021 të Përmbartuesit Privat Emine Sherifi-Lubeniqi.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.301/2021 i datës 25.11.2021 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi në Prishtinë.
- III. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve të procedurës përmbartimore për përpilimin e përgjigjes në prapësim të ia paguaj kreditorit shumën prej 312.00 € (treqind e dymbëdhjetë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi, duke vepruar sipas propozimit të autorizuarit të kreditorit “R...” sh.p.k, avokatit Sabri Kryeziu, në bazë të titullit ekzekutiv - Aktgjykimin të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.EK.nr.18/14 të datës 09.01.2020, ka nxjerr urdhrin P.nr.301/2021 me datën 02.11.2020, me të cilin ka caktuar zbatimin

e përmbarimit, ndaj debitorit “K...” sh.p.k. me seli në Prishtinë për pagesën e borxhit në shumën prej 10,885.00 €, pagesën e shpenzimeve të procedurës kontestimore në shumën prej 846.00 € si dhe shumën prej 312.00 € në emër të përpilimit të propozimit për përmbarim, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore të cilat do të llogariten nga përmbaruesi, duke i urdhëruar të gjitha bankat komerciale në të cilat debitori ka llogari të hapura që ti bartin mjetet materiale për të cilat është lejuar përmbarimi, në llogarinë e posaçme për kreditor tek autoriteti përmbarues dhe pastaj autoriteti përmbarues ta bëjë bartjen e mjeteve në xhirollogarinë bankare Nr. .... të autorizuarit te kreditorit, në xhirollogarinë bankare në P..., ose në qoftë se debitori nuk ka mjete në llogari, realizimi i kredisë të kreditorit të bëhet me regjistrimin, sequestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme që janë në pronësi të debitorit dhe nga mjetet e shitura të realizohet detyrimi i kreditorit.

Debitori përmes të autorizuarit të tij, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor duke shtuar se dokumentacioni i mangët dhe provat e referuara në urdhrin përmbarimor janë ende në proces gjyqësor meqenëse është paraqitur propozimi për përsëritjen e procedurës gjyqësore lidhur me këtë çështje juridike, andaj mbi këtë bazë i ka propozuar gjykatës që aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit, të shfuqizohet urdhri përmbarimor duke i kërkuar edhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit, në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se prapësimi i debitorit nuk është i bazuar në asnjërën nga shkaqet e përcaktuara në nenin 71 të LPP-së, duke theksuar se kreditori propozimin për përmbarim e ka paraqitur në bazë të dokumentit përmbarimor i cili është bërë i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor. I ka kërkuar shpenzimet e procedurës përmbarimore duke përfshirë edhe shpenzimet për përgjigje në prapësim në shumën prej 312 €.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata erdhi në përfundim se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, për faktin se në prapësimin e debitorit nuk janë dhënë arsye që prapësimi të pranohet si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbartimor, ndërsa e ka lënë në fuqi Urdhrin e Përmbartuesit Privat P.nr. 301/2021 të datës 25.11.2021, pasi që i njëjti është lejuar në bazë të dokumentit përmbartues (titullit ekzekutiv) – aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike IV.Ek.nr.18/14 i datës 09.01.2020.

Sipas dokumentit përmbartues (titullit ekzekutiv) - Aktgjykimit IV.EK.nr.18/14 të datës 09.01.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, debitori është detyruar që kreditorit të i paguaj në emër të borxhit, shumën prej 10,885.00 euro, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 846.00 €, brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjeti se dokumenti përmbartimor – Aktgjykimi IV.EK.nr.18/14 i datës 09.01.2020 i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike i formës së prerë nga data 21.10.2021 dhe i ekzekutueshëm nga data 18.11.2021 është dorëzuar në origjinal dhe i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së, i cili përcakton se: *“Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuksi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit– vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbartimi, objekti i përmbartimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit”*.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.1, përcaktohen dokumentet përmbartuese siç janë: *“vendimi përmbartues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbartuese;”*, ndërsa me nenin 23. par.1 përcaktohet se *“ vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdë gjyqësore konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës*

*dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit.”, dhe nenin 24 par. 1 përcaktohet të LPP-së përcaktohet se: “Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i pambarueshëm po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po që se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.”, ndërsa me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se “Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”.*

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se urdhri për përbarim i caktuar mbi bazën e titullit ekzekutiv – Aktgjykimit i plotëson kushtet për tu paraqitur si dokument përbarues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përbarimit, ngase janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.1, nenit 23 par.1, nenit 24 par. 1 dhe nenit 27 të LPP-së, pasi që dokumenti përbarimor, është i përbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përbarim, pasi që në të janë treguar palët përkatësisht kreditori dhe debitori është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet e debitorit se lidhur me këtë çështje është paraqitur propozimi për përsëritjen e procedurës si mjet i jashtëzakonshëm, mirëpo gjeti se një pretendimi i tillë i debitorit është i pa bazuar, pasi që propozimi për përsëritjen e procedurës nuk paraqet pengesë për realizimin e përbarimit.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejin e përbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 par.2 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumën prej 312 €, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifën e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.688/22, datë 21.11.2022

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi

palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve,

nga dita e pranimet të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë,

në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.